FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION

Raporti i garës së NIVELIT B

Data: 24 Maj 2025
Vendi: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, Prishtinë
Organizator: Federata e Gjimnastikës së Kosovës
Mbështetës: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Korporata Rugove, Liri (Prizren)

-Përshkrimi.
Më 24 maj 2025, Federata e Gjimnastikës së Kosovës organizoi garat e nivelit C në disiplinën e Gjimnastikës Artistike. Gara e nivelit C është niveli fillestar dhe paraqet një mundësi të mirë që fëmijët të fillojnë me gara si dhe poashtu ka qëllim masovizimin e gjimnastikës në vend.
Te paraqitura në garë ishin 180 gjimnast-e nga 9 klube pjesëmarrëse:
Akademia e Gjimnastikës Ardhmëria,
Klubi i Gjimnastikës Elita,
Klubi i Gjimnastikës Fushë Kosova,
Klubi i Gjimnastikës Halil Alidema Gjilan,
Klubi i Gjimnastikës Halil Alidema Viti,
Klubi i Gjimnastikës Kulina,
Klubi i Gjimnastikës Omnisport,
Klubi i Gjimnastikës Skenderaj,
Klubi i Gjimnastikës Vushtrria.

Gara u zhvillua në tri disiplina: parter, tra dhe kapërcime.
Medaljet u ndanë për çdo vit të lindjes veç e veç, me qëllim të motivimit dhe përfshirjes së të gjithë pjesëmarrësve.
Gjyqtaria u nda në tre panele dhe kishte këtë përbërje”
Parter: Abeliana Bregu, Drinesa Qerimi, Arlind Shaqiri
Tra: Doruntinë Ibrahimi, Valëza Rama, Vilëza Zeqiri, Xhevrije Fetahu
Kapërcime: Ard Kryeziu, Lisa Zeqiri, Elena Manxholli

Rregullimi i sallës u bë një ditë para garës nga punëtorët e angazhuar nga FGJK, dhe salla e garës kishte këtë pamje:



-Ecuria e garës.
Për shkak të numrit të madh të gjimnasteve të regjisturata në garë, komisioni i garave ka propozuar që gara të mbahet në dy termine, paradite nga ora 10:00 dhe pasdite nga ora 15:00 për gjimnastet e mbetura.

Takimi i trajnerëve dhe organizatorëve të garës u bë diten e garës nga ora 09:15.
Pas fjalës hapëse nga Kryetari i FGJK-së dhe intonimit të himnit shtetëror, gara filloi me rotacionet e mëposhtme sipas viteve të lindjes:

Paradite		
Rotacioni 1: Parter: 2020, 2019 Tra: 2018 Kapërcime: 2017	**Rotacioni 2:** Parter: 2017 Tra: 2020, 2019 Kapërcime: 2018	**Rotacioni 3:** Parter: 2018 Tra: 2017 Kapërcime: 2020, 2019

Në çdo vegël, para fillimit të ushtrimeve, gjimnastët patën disa minuta për nxemje.
Në orën 13:00 u mbajt ceremonia e ndarjes së medaljeve. Gjimnastet poashtu moren dhurata falë mbështetjes nga sponsori Liri, ndërsa sipas vendimit të Bordit të FGJK-së, u shpërblyen në total 8 gjimnaste për çdo vegël dhe çdo vit të lindjes, dhe me qëllim të motivimit të femijeve pasi që është garë e fillestareve, edhe gjimnastet tjera moren medalje që të përfshihen të gjitha.

Pasdite nga ora 15:00 filloj gara për grupmoshat tjera.

Pasdite		
Rotacioni 1: Parter: 2016 Tra: 2015 Kapërcime: 2014, 2013, 2012, 2011, 2010	**Rotacioni 2:** Parter: 2014, 2013, 2012, 2011, 2010 Tra: 2016 Kapërcime: 2015	**Rotacioni 3:** Parter: 2015 Tra: 2014, 2013, 2012, 2011, 2010 Kapërcime: 2016

Ceremonia e medaljeve për këtë grup u mbajt në ora 18:00 dhe përfundoi në ora 18:45, me të njëjtën mënyrë të ndarjes së shpërblimeve si te grupi i paraditës.
Mjeku ishte prezent gjatë tërë ditës, por fatmirësisht asnjë lëndim nga gjimnastet tona në këtë garë.
Punëtorët e angazhuar nga FGJK ishin prezent gjatë tërë ditës në garë dhe ndihmuan me lëvijen e paisjeve, mbajtjen e rendit, orientimin e publikut etj. Poashtu FGJK angazhoj edhe një fotograf që të kapen momentet në foto të bukura.

Përfundim

Gara u zhvillua në mënyrë të rregullt, me respektim të rotacioneve, zërimi ishte i mirë dhe kishte koordinim të mirë nga vullnetarët e FGJK-së. Aktiviteti u realizua me një pjesëmarrje të lartë të publikut dhe me atmosphere të mirë, dhe për shkak të numrit të madh publikun nuk e ka zënë lart në pjesen e shikuesëve prandaj kemi hapur edhe hapsiren poshtë për publik.
Mund të thuhet se gara e ka përmbushur qëllimin e saj dhe kemi marrë komente positive për organizim shumë të mire.

Disa foto nga gara:











